

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **Komuna e Mamushës**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	626-24-5207-1-2-1
Nr i brendshëm	626-24-008-1-2-1

Sa i përket tenderit për: **“Furnizimi me material shpenzues per laborator dhe material shpenzues dentar”**.

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

MEDPLUS SH.P.K

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Lebanë, Rr. Pranvera e Lirisë, p.n

(Adresa)

Prishtinë

(Vendi)

10000

(Kodi postar)

044640420

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Jeton Prenaj

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

medplusks@gmail.com

(Adresa elektronike)

02.08.2024

(Data e parashtrimt të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Data e njoftimit për kontratë: 21.06.2024
Hapja e ofertave 01.07.2024
Njoftimi mbi vendimin e AK-së dt.29.07.2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 62 i LPP-së
Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik.
Neni 43 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik.

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Të nderuar ne me dt.29.07.2024 përmes platformës elektronike e-prokurimi kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së ku është anuluar aktiviteti i prokurimit, me arsyetimin si më poshtë:

Gjatë vlerësimit të tenderit nga njësia kërkuese Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, kemi pranuar një shkresë për anulim të procedurës së prokurimit në fjalë pasi që pas shikimit të rastësishëm të paramasave nga ana e tyre, kanë vërejtur që ka gabime në paramasë pasi që është dorëzuar paramana e vjetër (për pajisjet e vjetra) për laborator ku tashmë shumica e artikujve të kërkuar nuk përdoren edhe nuk hynë në funksion të aparateve në njësinë e analizave. Gjithashtu në kërkesën e tyre, njësia e kërkesës ka cekur që është gabuar edhe të dhënia e përqindjes së ponetimeve për artikuj të caktuar pasi që në këta artikuj sasia e dhënë në përqindje është e pakët sepse tek artikujt më shumë të shfrytëzueshëm

kanë dhënë përqindjen më të vogël dhe si pasojë nuk mund të bëjnë furnizimet e mjaftueshme të cilat janë të domosdoshme për shfrytëzim si dhe lidhja e kontratës me specifika aktuale nuk do të mbërrinte qëllimin e kontratës dhe nuk do të kishte zbatim.

Pas analizimit të kërkesës, specifikeve teknike si dhe provave dhe fakteve dhe pas konsultimit me njësinë e kërkesës erdhëm në përfundim që edhe nëse do të nënshkruhej kontrata në fjalë, do të ishte e pa zbatueshme pasi që shumica e artikujve të nevojshëm nuk do të mund të furnizohen, ndërsa në kontratë do të përfshiheshin shumë artikuj të pa nevojshëm dhe kontrata nuk do të gjente zbatim.

Andaj duke u bazuar në atë që u tha më lartë, në dispozitat e nenit 62 të LPP-s si dhe nenit 43 paragrafi 43.5 pika (i) të RREGULLORES 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK me qëllim të shmangies së shkeljes së ligjit u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Neve na është dërguar letra standarde për tenderues të pasuksesshëm ku është shënuar si më poshtë:

Me keqardhje ju njoftojmë se tenderi i paraqitur nga ana juaj është i pasuksesshëm, pasi që i keni plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontrat por që procedura në fjalë është anuluar për shkak të gabimeve në specifika teknike dhe përqindjes së dhënë në para-masë nga njësia kërkuese për disa pozicione të caktuara në të dy pjesët.

Sa i përket arsyes së anulimit, sqarojmë se nuk është në kompetencë të njësisë kërkuese anulimi i procedurave të prokurimit, por përgjegjësitë e njësisë kërkuese janë të hartojnë specifikimet teknike dhe paramasën.

Pavarësisht se çfarë shkrese ka dërguar njësia kërkuese, ZPP nuk mund të anulojë aktivitetin e prokurimit pa bazë ligjore dhe njësia kërkuese nuk është përgjegjëse për zhvillimin e procedurave të prokurimit, prandaj kjo arsye e anulimit është e pa bazuar dhe e paqëndrueshme.

Po ashtu edhe arsyetimi se është bërë gabim tek dhënia e përqindjes së poentimit për artikuj të caktuar është arsyetim absurd dhe nuk ka mbështetje ligjore e as profesionale.

Përqindja për artikuj është dhënë sipas nevojave dhe kërkesave të AK-së, kur dihet fakti se këto janë parashikuar në fillim, para shpalljes së tenderit nga vetë autoriteti kontraktues dhe përderisa nuk është bërë hapja e ofertave nuk ka pas asnjë reagim as nga njësia kërkuuese e as nga zyra e prokurimit.

Sa i përket arsyetimit se kontrata në këtë mënyrë është e pazbatueshme, sqarojmë se ky konstatim është plotësisht i pasaktë dhe jo profesional e subjektiv, sepse kjo kontratë është e zbatueshme konform nevojave të AK-së.

Hapja e ofertave është bërë me dt.01.07.2024, kurse njoftimi mbi vendimin është bërë me dt.29.07.2024, e që ky fakt tregon qartë se nga data e hapjes janë analizuar në detaje ofertat dhe kur është konstatuar se ne jemi ofertues i përgjegjshëm dhe jemi me çmim më të ulët, atëherë është inskenuar një veprim i tillë për të anuluar këtë tender dhe për të mos na rekomanduar neve për kontratë.

Anulimin e kësaj procedurë të prokurimit me këto arsyetime nuk mund ta kuptojmë ndryshe përveç se tendencë diskriminimi ndaj kompanisë tonë, kur kem parasysh faktin se ne jemi ofertuesi më i lirë dhe i plotësojmë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se është vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë Çmimin më të ulët me peshim, sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Pra, duke i pasur parasysh të gjitha faktet në lidhje me kronologjinë dhe ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit, rezulton se ky aktivitet i prokurimit është anuluar në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së, sepse nuk janë përmbushur asnjëra nga kushtet e parashikuara në këtë dispozitë.

Anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bërë në kundërshtim edhe me nenin 43.5 dhe 43.7 i Rregullores nr.001/2022 Për Prokurim Publik, sepse nuk janë plotësuar asnjëra nga kushtet e kësaj dispozite, ndërsa ju sqarojmë se ne jemi ofertues i përgjegjshëm dhe i plotësojmë të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë dhe jemi me çmim më të ulët.

Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që *“Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente, ndërsa AK-së nuk e ka zbatuar këtë dispozitë duke na diskriminuar neve.*

Po ashtu nuk është marrë në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga ju që të merrni:

VENDIM

- I. **APROVOHET**, e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE **MEDPLUS SH.P.K.**,
- II. **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin e AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe lënda të kthehet në **RISHQYRTIM** dhe gjatë rishqyrtimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 5,000.00 euro.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*